



informationen

albanisch



Jungwacht Blauring...

...me 31.000 anëtarët e saj që ka, është asociacioni më i madh katolik për fëmijë dhe të rinjë në Zvicrën Gjermane. Në Jungwacht Blauring fëmijët dhe të rinjtë mundën që të shpalosin idetë dhe mundësitë e tyre. Një ofertë e shumëllojshme me aktivitete ju krijon mundësinë të përjetoni gjëra të reja dhe të zbuloni aftësitë tuaja. Jungwacht Blauring është e lidhur me Kishën Katolike, mirëpo e hapur për fëmijë dhe të rinjë, pa dallim feje dhe kulture.

Në nivel famullie, në mënyrë zyrtare, për rrafsh 15`000 vajza dhe 10`000 djem, përkujdesen afër 7`000 udhëheqëse dhe udhëheqës të rinjë. Vajzat, aktivitetin e tyre mundën ta zhvillojnë në Blauring, ndërsa djemtë, në Jungwacht. Në disa famulli, Blauring dhe Jungwacht janë bashkuar tek Jubla, dhe takohen në grupe të përziera.

Jeta në Jungwacht Blauring, parasegjithash, zhvillohet tek fëmijët e grupmoshave të njëjta. Të gjitha grupet e fëmijëve, të një famullie, së bashku, krijojnë Schar-in. Udhëheqësia e Schar-it dhe pjesa tjetër udhëheqëse e Schar-it, planifikojnë dhe koordinojnë jetën e përbashkët në Schar, e që çdo vit përmbanë disa aktivitete.

Anëtarët e Jungwacht Blauring, jetojnë sipas këtyre parimeve themelore:

me qenë së bashku
me vendos bashkërisht
me besue në jetë
me qenë kreativ
me përjetue natyrën

Ne ofrojmë...

...një hapësirë të lirë, ku fëmijët dhe të rinjtë, mundën t'i shfaqin idetë e tyre, dhe ku munden të akceptohen.

...një angazhim të lirë dhe kuptimplotë, që nxit ngritjen e përgjegjësisë dhe mundësonë përvoja të reja jetësore.

...një ofertë me aktivitete të shumëllojshme, që realizohet bashkërisht nga fëmijët dhe të rinjtë.

...një bashkësi, që besimi dhe ritet luajnë një rol të rëndësishëm.

...një vend, ku fëmijët dhe të rinjtë, pa ndonjë presion, i zbulojnë dhe përjetojnë aftësitë e veta.

...një vend, ku fëmijët dhe të rinjtë, ndihmohen të kalitin vetëbesimin.

...gëzim jetësor – miqësi jetësore.

Takimet në grupe...

...quhen takimet e përbashkëta të grupeve të veçanta të fëmijëve të një Schar-i. Tani për tani, saktë, gjashtë deri në njëzetë vajza dhe djem, të moshave të njëjta, marrin pjesë në këto takime të grupeve. Sipas Schar-it, këto takime janë; javore, dy javore apo edhe mujore, dhe mbahen në ditë të ndryshme të javës.

Çdo grup i fëmijëve është nën përkujdesje dhe udhëhiqet nga një, deri tre të rinjë. Këta të rinjë, edukohen dhe mësohen me qëllim që të jenë plotësisht të aftë në obligimet e tyre ngase, ata, shpeshherë janë persona përgjegjës dhe shembull për fëmijët. Udhëheqësit organizojnë aktivitete me përmbajtje të larmishme si: të jeshë kreativ, luarje lojërash, diskutime të përbashkëta, bërje sport, gjurmim të natyrës, përjetim shëtitjesh, lojëra teatri, këndim, vallëzim, vizatim, artizanate, gatim dhe shumëçka tjetër. Gjitha këto aktivitete, fëmijëve duhet t'u mundësojnë një kohë të lirë, të shumëllojshme, e cila sjell kënaqësi.

Aktivitetet e Schar-it...

...quhen të gjitha takimet e të gjitha grupeve të fëmijëve dhe të udhëheqësve të një Schar-i. Në këto aktivitete, takohen të gjithë anëtarët e një Schar-i, duke filluar nga më i riu e deri tek më i vjetri. Edhe në këto aktivitete, shpeshësia e takimeve varet nga secili Schar veç e veç. Shpeshherë, pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete rregullohet përmes nifotimeve, kështu që këta, varësisht nga koha dhe dëshira munden të marrin pjesë bashkërisht.

Ekipi udhëheqës përgatit një program vjetor, e që fëmijëve dhe prindërve me kohë ju paraqitet. Varësisht nga stinët e vitit këto oferta mund të jenë të karaktereve të ndryshme si: rrëshqitje me saj dhe disko për Fasnacht gjatë sezonit të dimrit; turne të lojërave, lojëra të ndryshme në natyrë, takime me karakter religjioz, buajtje në çadra në fundjavë, Kino e hapur në natyrë, retrospektivë të kampimit, grill me mishëra dhe perime gjatë sezonit të verës; Party me rastin Halloweenit dhe festim të Krishtëlindjeve në mal, gjatë gjatë fundvitit.

Kampimi...

...janë pikat vjetore më kulminante në Jungwacht Blauring. Me çanta dhe gjësende të tjera, i tërë Schar-i udhëton për një ose dy javë në kampime verore, vjeshtore apo dimërore. Buajtjet mund bëhen në ndonjë shtëpi të përbashkët, apo edhe në tenda, në ndonjë vendkampim.

Lojë dhe sport, aktivitete kreativ dhe artizanate, këndim për rreth zjarrit, momente relaksimi, ditë të ndjenjave të mira, objekte të lojërave dhe të tjera momente të mrekullueshme i përkasin përditshmërisë së kampimit dhe mbesin shpeshherë shumë gjatë në kujtesë. Që kampimit t'i jepet vello më interesante, udhëheqësit, të gjitha pjesët e veçanta të programit i përbashkojnë nën një moto të vetme. Kështu, që, nuk do të habiteni pastaj aq shumë nëse, gjatë kohës së pushimit, piratët presin trenin, jashtëtokësorët rrijnë për rreth zjarrit të kampit, apo indianët gjurmojnë margaritarë në qytet...

Baluring- , Jungwacht dhe Jublalager (Jublakampimi) organizohen nga shumica e Schar-eve si ofertë: të rinjtë + sporti në lëminë e Sportkampimit/Trekking-ut. Kështu, kampimi i përmbushë rregullativat e sigurisë dhe kërkesat e, të rinjtë + sporti. Në këmbim të kësaj, të rinjtë e Schar-it, marrin ndihmë financiare, gjësende për përgatitje të kampimit, mundësi shkollimi, material mësimor, etj.. Këto shërbime dhe angazhimi i madh i ekipit udhëheqës, janë një ndihmesë që sjell sukses për secilin kampim.

Ekipi udhëheqës...


...përbëhet nga një grup i të rinjëve, afërsisht rreth moshës 16 – 25 vjeçare. Tek të gjitha aktivitetet e Jungwacht Blauring, ky ekip, bartë përgjegjësi dhe tregon rezultate mjaft të çmueshme në punët paraprake. Për këtë arsye, të dyja asociacioneve - për fëmijë dhe të rinjë, u jepet rëndësi dhe mundësi e çmueshme slodie për arsimim dhe shkollim të mëtutjeshëm të udhëheqësve. Në bashkëpunim me; të rinjtë + sporti, Jungwacht Blauring ofron kurse arsimimi të nivelit kantonal dhe zviceran (shtetëror). Këto mundësi arsimimi të mëtutjeshëm janë për të rinjtë e të gjitha grupmoshave dhe transmetojnë bazat themelore për një punë qëllimmire të fëmijëve dhe të të rinjëve.

Çdo ekip udhëheqës është pjesë e strukturës së Jungwacht Blauring, andaj kjo u krijon atyre mundësi që t'u vijë ndihmë nga të gjitha anët. Nga njëra anë, çdo Schar menaxhohet nga një trajner, dhe shpeshherë nga një udhëheqës religjioz shpirtëror (Präses). Si njerëz me përvojë jete dhe arsimim adekuat, ata janë një mbështetje e fortë për, shpeshherë ekipin e ri udhëheqës. Nga ana tjetër, si anëtarë i Asociacionit Kantonal, Schar-i, është nën përkujdesje të Këshillit Kantonal të Nderit, gjë që përfiton nga kjo në oferta për arsimim, gjësende ndihmëse, këshillime etj..

Duke ju falëndruar punës së tyre të palodhshme - ekipi udhëheqës i Jungwacht Blauring, çdo vit kryenë mbi 3`000`000 orë punë vullnetare! 32`000 fëmijëve dhe të rinjëve u mundësohen orë kënaqësishë të paharruara.

Interesim për Jungwacht Blauring?

Kontakti



Informacione të mëtutjeshme

Bundesleitung Jungwacht Blauring
St. Karliquai 12
6004 Luzern

041 419 47 47
info@jubla.ch
www.jubla.ch